REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: SP-02
Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot.No: 2147-2/23
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No.Pages: –
Data / Datum / Date: 05.05.23
PRISHTINË / A No.1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosova**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 05.05.2023 |
| **REFERENCË:** | |
| **PËR/ZA/TO:** | Mustafë Bekteshi (person i autorizuat) nga:<br>Limak Kosovo International Airoport J.S.C.<br>Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"<br>tel. 049/911-080<br>email: mbekteshi@limakkosovo.aero |
| **CC:** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Vendim për Leje Ndërtimore për "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit |

I nderuar,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin ndërtimor për leje ndërtimi me nr. protokolli 2147/23 të datës 25.04.2023 nga parashtruesi i kërkesës z. Mustafë Bekteshi (person i autorizuar me nr. kartelës: 0110464) nga Limak Kosovo International Airoport J.S.C. - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", adresa 10070 Vrellë, Lipjan, për ndërtimin e "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit, dhe vlerësoi si vijon:

Bashkangjitur me këtë shkresë përcjellëse gjeni Vendimin për Leje Ndërtimore.

Me nderime,

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosova**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

Data: 05.05.2023 Numri i vrojtimit të lejes: K.III-03/2023

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenet 14, 15, 19, 20, 21, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 21, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lëshon këtë:

**VENDIM**
**(për Leje Ndërtimore)**

| **Kjo leje ndërtimore i lëshohet:** | | | |
|---|---|---|---|
| Emri: | LIMAK KOSOVO INTERNATIONAL AIROPORT J.S.C., Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" | | |
| Adresa: | 10070 Vrellë, Lipjan | | |
| Telefoni: | +383 (0) 49 911 080 | Emaili: | mbekteshi@limakkosovo.aero |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Emri i Projektit: | "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit | | |
| Emri i Projektuesit: | "VIZARK" Sh.P.K.<br>"TERMOVENT" Sh.P.K. | | |
| Adresa: | Rruga "Agim Ramadani" H 82/4, Prishtinë<br>Rruga "Ndue Përlleshi" L1-1-Lok-1-L, p.n. Prishtinë | | |
| Telefoni: | +383(0) 44/276606<br>+383(0) 44/674819<br>+383(0) 49/860591<br>+383(0) 46/143401 | Emaili: | vizark.info@gmal.com<br>vizark.info@gmal.com<br>info@termovent-ks.com<br>info@termovent-ks.com |

| **Për punët ndërtimore si në vijim:** |
|---|

<table>
<tr><td>Adresa<br><br><br><br><br><br><br>Zona Kadastrale<br>ZK.Vrellë e Goleshit</td><td>Vendndodhja e planifikuar për ndërtimin e "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës", ndodhet në Komunën e Lipjanit, Zona Kadastrale Vrellë e Goleshit, në njësitë kadastrale P-71409016-00085-0 dhe P-71409016-00084-1, rreth 2,7 kilometra nga magjistralja M9 Prishtinë - Pejë.<br><br>1. Në kuadër të lokacionit të Aeroportit ekzistues është projektuar ndërtimi i "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës" duke i bashkangjitur objektit të terminalit ekzistues për t'i plotësuar nevojat në rritje për hapësira administrative-zyre për shërbime pasagjerëve të terminalit me etazhitet P+0 me sipërfaqe 757.45m$^2$, do të ndërtohet në nr.par. 00085-0 dhe 00084-1;<br><br>Qasja në aneks objekt bëhet nga dy hyrje, njëra hyrje e lidhur drejtpërdrejt nga holli i terminalit ekzistues, ndërsa hyrja tjetër nga jashtë.</td><td>GPS Koordinatat:<br>1. x=7502371.72; y=4715112.23;<br>2. x=7502389.02; y=4715113.54;<br>3. x=7502374.40; y=4715076.85;<br>4. x=7502391.71; y=4715078.14;<br>5. x=7502393.60; y=4715052.41;<br>6. x=7502401.98; y=4715053.04;<br>7. x=7502402.17; y=4715050.54;<br>8. x=7502389.90; y=4715048.61;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Lloji i ndërtimit:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Ndërtim i ri ☒ Rindërtim ☐ Rrënim ☐ Riparim ☐</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kategoria e ndërtimeve të propozuara:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kategoria I ☐ Kategoria II ☐ Kategoria III ☒</td></tr>
<tr><td>Përdorimi i propozuar:</td><td colspan="2">A përfshinë projekti ndryshim të përdorimit? Po ☐ Jo ☒</td></tr>
<tr><td colspan="3">Shtëpi ☐ Banesë kolektive ☐ Përdorim i përzier ☐ Komercial ☐<br>Industrial ☐ Infrastrukturë ☒ Tjetër: "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrimi: "Aneks objekti i Terminalit - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës", Komuna e Lipjanit është ndërtim i ri dhe nuk do të ketë ndryshim të përdorimit.</td></tr>
</table>

**Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë sw saj në pajtim me Ligjin;

- Të sigurojë që punëkryesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:

  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;

  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe punëkryesit, nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;

- një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;

- dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;

- librin ndërtimor dhe ditarin e punës, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore, përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;

  - të njofton inspektoratin e MMPHI-së mbi synimin për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

  - të kontaktojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

  - të mos bëj asnjë ndryshim në projekt pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e autoritetit kompetent i cili ka dhënë lejen e ndërtimit – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;

  - të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## A r s y e t i m

Aplikuesi z. Mustafë Bekteshi (person i autorizuar me nr. kartelës: 0110464) nga Limak Kosovo International Airoport J.S.C., Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", adresa 10070 Vrellë, Lipjan, në bazë të kërkesës me nr. protokolli 2147/23 të datës 25.04.2023 ka kërkuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, leje ndërtimi për ndërtimin e "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit.
Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të tërësishëm ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore lëshohet duke u bazuar në shqyrtimin e këtyre provave:

- Vendimi për Kushtet Ndërtimore për projektin e "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit, me nr. prot. 6387-2/22 me datë 12.04.2023 nga MMPHI;
- Vendim për Pëlqim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për projektin "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroportit Ndërkombëtar

i Prishtinës" Komuna e Lipjanit, me nr. prot. 4997-2/22 të datës 21.10.2022 nga MMPHI;

- Pëlqim nga Ministria e Punëve të Brendshme - Agjencia e Menaxhimit Emergjent me Nr.0001936/22 të datës 23.08.2022, lëshon pëlqim të dokumentacionit investiv teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri;
- Pëlqim nga Instituti Arkeologjik i Kosovës me numër të protokollit 289-3 të datës 25.08.2022, Ju njoftojmë se nuk kemi të dhëna për gjurmë të Trashëgimisë Kulturore Arkeologjike në hapësirën – territorin ku shtrihet Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari";
- Pëlqim nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Financave – Komiteti për Partneritet Publiko Privat, me numër të protokollit 2992-1/2022/23 të datës 24.02.2023 përmes së cilës është dhënë pëlqimi për Ndërtimin e 754.45m2 shtesë të hapësirës komerciale në terminal;
- Kopja e Planit dhe certifikata e njësisë kadastrale me nr. P-71409016-00085-0 dhe P-71409016-00084-1, ZK Vrellë e Goleshit - Komuna e Lipjanit, Pronari Aeroporti Ndërkombëtar Sh. A. I Prishtinës.
- Tri (3) kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike;
- Dëshmi mbi pagesën e taksës.

**Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet, situacioni i ngushtë "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të kësaj Leje Ndërtimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Nr. 487 datë: 05.05.2023 Prishtinë

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Komunës së Lipjanit,
3. Kabinetit të Ministrit,
4. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
5. Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit,
6. Inspektoratit të MMPHI-së,
7. Arkivit të MMPHI-së

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së




## KOORDINATAT E OBJEKTIT

| | X | Y |
|---|---|---|
| 1 | 7502371.725 | 4715112.233 |
| 2 | 7502389.029 | 4715113.544 |
| 3 | 7502374.406 | 4715076.850 |
| 4 | 7502391.710 | 4715078.145 |
| 5 | 7502393.609 | 4715052.412 |
| 6 | 7502401.989 | 4715053.047 |
| 7 | 7502402.178 | 4715050.548 |
| 8 | 7502389.908 | 4715048.611 |

Emri i Projektit

ANEKS OBJEKT

Adresa

Vrellë, Lipjan

Investitori

Limak

Studio Projektuese

VIZARK

Nezir Gashi str, 36 | 10000 Prishtinë
www.vizarkstudio.com

Faza: PROJEKTI KRYESOR

Pjesa e Projektit: ARKITEKTURA

Përmbajtja e Faqes

**Situacioni i ngushtë - koordinatat**

Përpjesa: **1:200**

Nr. i Faqes: A16

Projektues

Ilir Loshaj, MA ark.
Fuat Prebeza, MA ark.*
Lirije Loshaj, MA ark
Jetmir Jahaj, MA ark*
Festina Mustafa, MA ark*

Prill 2023

REPUBLIKA E KOSOVËS

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
VIZARK
SH.P.K.
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia / Jedinica / Unit: DPHNB
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No: 2147-2/23
Nr. i faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 07
Data / Datum / Date: 05.05.23
PRISHTINË / A
No. 1

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria –Vlada-Government*

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure***

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit / Departament Prostornog Planiranja, Gradnje i Stanovanje / Department of Spatial Planing, Construction and Housing

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | | | | | |
| **PËR/ZA/TO:** | | **Servet Spahiu,** Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të (MMPHI) | | | |
| **CC:** | | | | | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | | **Xhemail Metolli,** Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | | **Naime Pakashtica** - Zyrtare për rregullore teknike | | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | | Draft-Vendim për Leje Ndërtimore për "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit | | | |
| **Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:** | **1417** | **Lokacioni: Kucni: Extension:** | **Prishtinë** | **Data: Datum: Date:** | 05.05.2023 |

I nderuar Sekretar,

Departamenti i Planifikimit Hapësinorë, Ndërtimit dhe Banimit - Divizioni i Ndërtimit, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin ndërtimor për leje ndërtimi, me nr. prot. 2147/2023 të datës 25.04.2023 nga parashtruesi i kërkesës z. Mustafë Bekteshi (person i autorizuar me nr. kartelës: 0110464) nga Limak Kosovo International Airoport J.S.C., Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", adresa 10070 Vrellë, Lipjan, për ndërtimin "Aneks i objektit të Terminalit - Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës" Komuna e Lipjanit, dhe vlerëson si në vijim:

Me respekt,



Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
adresa: Ish pallati i mediave "Rilindja" kati 14, nr. 1418, tel: +381(0) 38 200 32 553